



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 34/1 Prot.

Tiranë, më 17. 01. 2019

V E N D I M

Nr. 06, Datë 17. 01. 2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 4, datë 08.01.2019, e Sh. T., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shoqërore” dhe “gjendja shëndetësore”¹ nga ana Bashkisë Tiranë dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës dhe dokumentacioni bashkëlidhur saj, rezulton se ankuesi Sh. T. është njoftuar në muajin shkurt 2018, se rrethinat e shtëpisë së tij do të prishen nga firma zbatuese “Gjoka Konstruksion”, e kontraktuar nga Bashkia Tiranë, pasi në rrugën “Ali Pashë Tepelena” është duke u zbatuar një projekt i Bashkisë së Tiranës, për rikonstruksionin e kësaj rruge. Projekti në fjalë ka emërtesën “Rikonstruksion i infrastrukturës së Bllokut që kufizohet nga rruga Endri Keko, Sadik Petrela dhe Lana”. Projekti i sipërpërmendur parashikon ndërtimin e rrjetit të ri KUZ dhe KUB, ndriçim etj. Ankuesi Sh. T. shprehet se ka dërguar disa herë kërkesa pranë Bashkisë Tiranë, ku ka kërkuar informacion zyrtar, nëse ndërtesa e tij me nr. pasurie x/xxx, zona kadastrale xxxx, e ndodhur në rrugën “Sadik Petrela” (“Ali Pashë Tepelena”) do të preket nga projekti në fjalë. Ai thekson faktin se edhe pasuritë e dy familjeve të tjera që ndodhen në krahun perëndimor dhe atë lindor të së njëjtës zonë, ku ndodhet edhe pasuria

¹ Referuar kopjes së librezës së verbërisë Nr. xxxxx, lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

e ankuesit, të cilat sipas tij duhet të përfshiheshin në projektin e sipërpërmendur të Bashkisë Tiranë, nuk janë përfshirë, sepse pronarët respektivë kanë njohje me zyrtarë të IMT-së dhe lidhje familjare. Sipas ankuesit, pasuritë (trualli) e pronarëve fqinjë me të kanë të njëjtin status juridik, me pasurinë e tij, por rruga nuk po rikonstruktohet ashtu siç duhet dhe projekti i Bashkisë Tiranë është miratuar në mënyrë të tillë për të favorizuar këta pronarë.

Në këtë kontekst, përmendim se Bashkia Tiranë ka dërguar në adresë të ankuesit, si përgjigje të kërkesave të tij, përkatësisht shkresën nr. Sh-4684/1, datë 13.03.2018, shkresën nr. Sh-7084/1, datë 16.04.2018, shkresën nr. SH-26516/1, datë 29.10.2018 dhe shkresën nr. SH-30178/2, datë 21.12.2018.

Në shkresën nr. Sh-4684/1, datë 13.03.2018, të Bashkisë Tiranë drejtuar ankuesit sqarohet: *“Referuar çertifikatës së pronësisë që ju keni depozituar pranë Bashkisë Tiranë, të lëshuar nga ZRPP Tiranë, me nr. 1014420, datë 17.12.2015, si dhe projektit të miratuar me Vendimin e Këshillit Teknik nr. 10/11, dtë 25.05.2017, depozituar pranë Drejtorisë së Pasurive të Paluajtëshme me shkresën nr 7740, datë 22.02.2018, rezulton se pasuria me nr. x/xxx ND (ndërtesë), nuk preket nga zbatimi i projektit të miratuar. Për sa i përket truallit me nr. pasurie x/xxx, i cili preket nga projekti i sipërcituar, sipas shënimit në seksionin D të kartelës së pasurisë nr. x/xxx ND, Vol. x, Faqe xx, figuron në pronësi të shtetit.”* I njëjti fakt përforcohet edhe në shkresën nr. SH-7084/1, datë 16.04.2018, të Bashkisë Tiranë. Ndërkohë që, në shkresën nr. SH-30178/2, datë 21.12.2018, të Bashkisë Tiranë drejtuar ankuesit, theksohet fakti *“...Gjithashtu për të gjithë pretendimet që ju keni ngritur, jeni sqaruar nga ana e Drejtorisë sonë në mënyrë zyrtare me anë të përgjigjeve tona me nr. Prot. Sh-252019/1, datë 11.10.2018, nr. Prot. SH-26516/1, datë 29.10.2018, nr. Prot. SH-29802/1, si dhe janë bërë disa takime me ju në zyrat tona dhe në objekt në prani të inxhinierit të sipërmarrësit, specialistëve të drejtorisë sonë, si dhe të drejtorit të DIPP.”*

Në vijim ankuesi ka pretenduar se nuk ka marrë përgjigjen e kërkuar nga ana e Bashkisë Tiranë dhe në këto kushte i është drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me një ankesë. Në përgjigje të saj, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me anë të shkresës Nr. 1801/1 prot., datë 19.12.2018, ka informuar ankuesin ndër të tjera se: *“...Me emailin datë 18.12.2018, të cilin e gjeni bashkëlidhur, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje lidhur me informacionin e kërkuar, duke cituar ndër të tjera që ky është i gjithë dokumentacioni që ky i fundit disponon. Përsa më sipër, në kuptim të ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, objekti i ankesës tuaj vlerësohet i përmbushur.”*

Pavarësisht sa më sipër, ankuesi ngre pretendimin e tij për diskriminim, për shkaqet e sipërpërmendura, ndaj Institucioneve të Bashkisë Tiranë dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi pretendon se edhe pas ankesës së bërë pranë këtij të fundit, nuk ka marrë përgjigjen e kërkuar nga ana e këtyre institucioneve.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe në ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Përsa më lart dhe mbështetur në parashtrimet e bëra në ankesë, ankuesi ka ngritur pretendimin se subjektet ndaj të cilëve ka paraqitur ankesë, nuk i është dhënë informacioni që ai ka kërkuar. Duke iu referuar dokumentacionit bashkëngjitur ankesës, Sh. T. në mungesë të informacionit të dhënë nga ana e Bashkisë Tiranë i është drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe

Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili në përfundim ka vlerësuar të përmbushur detyrimin për dhënie informacioni nga ana e Bashkisë Tiranë në përgjigjet e vëna në dispozicion të ankuesit. Në këto kushte dhe në mbështetje të parashikimeve të nenit² 24, pika 1 të ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, autoriteti përgjegjës për të drejtën e informimit është institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili i ka shqyrtuar ankesën e Sh. T.

Referuar më sipër, Sh. T. nuk ka vënë në dispozicion asnjë informacion, provë apo indicie, me anë të së cilës të argumentojë trajtimin në mënyrë më pak të favorshme apo diskriminuese nga ana e Bashkisë Tiranë apo Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, por ankesën e bërë e ka mbështetur vetëm në mungesën e informacionit. Pra, Sh. T. nuk ka paraqitur asnjë informacion apo argument që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të krijojë bindjen e trajtimit të tij në mënyrë më pak të favorshme për një nga shkaqet e parashikuara në Ligjin nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 33, pika 4/ç të tij, parashikon se: “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”.

Në përfundim, duke analizuar në tërësi ankesën Nr. 4, datë 08.01.2019, të Sh. T., Komisioneri gjykon se, në rastin konkret në mungesë të informacionit të mjaftueshëm për shqyrtimin e saj, ankesa nuk mund të pranohet dhe t’i nënshtrohet procedurave të hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 12, 20, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç) të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 4, datë 08.01.2019, së Sh. T., pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë,

² Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.

brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja shoqërore dhe shëndetësore)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)